

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 04.04.2013
Nr. 0204-379

PËR: Pal Lekaj, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Xhavit Alijaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS, 01 Nr. 011 - 1812, Pranuar me datë, 27.03.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin nr.03/L -139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligjin nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 011 -1812 të miratuar me datë 25.03.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 011 -1812 Shpallet interesi publik në dobi të Komunës së Gjakovës, për realizimin e projektit energjetik të kompanisë Amerikane TCG "GREEN ENERGY"

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 04.04.2013
br. 0204-379

Za: Pal Lekaj, Gradonačelnik opštine Đakovica
Xhavit Alijaj, Predsedavajući Skupštine opštine Đakovica

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Đakovica, 01 br. 011 - 1812, primljeno
dana , 27.03.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, zakonom br.03/L -139 o eksproprijaciji nepokretne imovine i zakonom br. 04/z-144 o davanju na koristi i razmenu nepokretne imovine, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 02-033 odobreno dana 28.02.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,


- Odluka 01 br. 011 -1812 objavljivanje javnog interesa u korist opštine Đakovica, za realizaciju elektronskog projekta američke kompanije TCG "GREEN ENERGY"

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

Ministria e Administrimit Lokalit dhe i Qytetit Ministry of Local Government Administration			
Data: 27.03.2013			
Numri i aktit	004-379	Shifra	5



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. 011-1812 /2013
Dt. 25.03.2013

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 4 pika 1.2 dhe 1.3 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenin 10 pika 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.03.2013, pas diskutimeve lidhur me pikën e II-të të rendit të ditës: Miratimi i vendimit për shpalljen e interesit publik në parcelat: nr.5025 në sipërfaqe prej 1.42,26 ha, nr. 5026 në sipërfaqe prej 0.79,01ha , nr. 5027/1 në sipërfaqe prej 0.66,12ha, nr. 5027/2 në sipërfaqe prej 0.54,89ha dhe nr. 5028/2 në sipërfaqe prej 0.73,25ha, të gjitha të evidentuara si prona të KBI "Ereniku", në Zonën Kadasatrale Gjakovë – jashtëqitet, për realizimin e projektit të riciklimit të mbeturinave dhe ngritjes së termocentralit për prodhimin e energjisë termike dhe elektrike, sipas projektit të kompanisë TCG. "GREEN ENERGY", e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Shpalljet interesi publik në dobi të Komunës së Gjakovës, për realizimin e projektit energjetik të kompanisë Amerikane TCG. "GREEN ENERGY" - Zyra në Prishtinë në paluajtshmëritë sipas të dhënave vijuese:

a.Shpallet dhe caktohet interesi publik në dobi të Komunës së Gjakovës, në ngastrën kadastrale rr. 5028/1,në sipërfaqe prej 0.78,32 ha, e evidentuar në ZK Gjakovë – jashtëqytet në pronësi të Komunës së Gjakovës, për realizimin e projektit energjetik të kompanisë Amerikane TCG. "GREEN ENERGY" - Zyra në Prishtinë.

b. Shpallet dhe caktohet interesi publik në dobi të Komunës së Gjakovës, në ngastrat kadastrale nr.5025 në sipërfaqe prej 1.42,26ha, nr. 5026 në sipërfaqe prej 0.79,01ha , nr. 5027/1 në sipërfaqe prej 0.66,12ha, nr. 5027/2 në sipërfaqe prej 0.54,89ha dhe nr. 5028/2 në sipërfaqe prej 0.73,25ha, të gjitha të evidentuara si prona të KBI "Ereniku", në Zonën Kadasatrale Gjakovë –jashtëqitet, për realizimin e projektit energjetik të kompanisë Amerikane TCG "GREEN ENERGY"-Zyra në Prishtinë.

Procesi i shpronësimit të paluajtshmërive të KBI " ERENIKU" të evidentuara në këtë pikë, mund të realizohet në harmoni me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

II. Shpallja e Interesit publik në ngastrat kadastrale të përshkruara në pikën e parë të këtij vendimi, e arsyetojnë qëllimin e ligjshëm publik për realizimin e procesit të shpronësimit të paluajtshmërive në të cilat planifikohet ngritja e objekteve energjetike sipas projektit të kompanisë Amerikane TCG "GREEN ENERGY"- Zyra në Prishtinë, ndërsa procesi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale, në kohëzgjatje prej 30 vjetësh, duhet të realizohet në harmoni me nenin 10 pika 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe me nënshkrimin nga Kryesuesi i Kuvendit.

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës
- Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Xhavit Alija